



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA JURIDIKE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Vlorë, më ____ . ____ . 2026

PROCESVERBAL-Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**
(Ky procesverbal është përfekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje matëriale pastrimi, detergjent”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 39831200-8
VLERA E FONDIT LIMIT 5,083,320.00 (pesë million e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e njëzet
)Lekë pa TVSH.**

Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76, pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe studimit të tregut, fondi limit u përlllogarit bazuar në mesataren e cmimeve të marra nga ky studim.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 2, pika 2/c dhe neni 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: *"...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik..."*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP *"Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël"*, Neni 82, i LPP *"1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik"*.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas Shtojcës 8, pika 1 "Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit"

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, si edhe në nenin 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të prokuruar.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2/b dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare", pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë*

maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndersa ne piken 2/b citohet: vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, ndersa ne piken 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor, per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten. Gjithashtu vendosja e kriterëve ne reference eshte bere që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3 e LPP, ne nenin 43 pika 1, pika 2/b dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë” i ndryshuar, si edhe në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

Në percaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2/b, të Nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni,

si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Kjo kërkesë është bërë në përputhje me pëcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, sipas të cilit, operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitet.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së përllëgaritur të kontratës që po prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e

nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- **ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;**

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë transportin dhe dorëzimin mallrave objekt prokurimi, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor në adresën e përcaktuar.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, 40, pika 8.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe zërave të preventivit objekt i kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për skadencën e mallrave, e cila duhet të jete me afat jo më pak se 1 (një) vit nga momenti i levrimit të mallit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mjetin e ofruara nga operatori ekonomik.

- 2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/skedë teknike për mallrat objekt prokurimi. Në katalogun/skedën teknike të paraqitur duhet të shenjohen në mënyrë të dukshme specifikimet teknike përkatëse, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së tyre sipas kërkesave teknike në dokumentat e tenderit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

Argumentimi i specifikimeve teknike : Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës, bashkëngjitur DST në SPE.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.